



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK TË VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR KUJDESHIN ALTERNATIV NË FAMILJE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

1. Titulli i projekt-aktit

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për propozimin e projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi publik i projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për propozimin e projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” ka patur një kohëzgjatje 28 ditë kalendarike nga momenti i shpalljes në regjistrin elektronik të konsultimeve publike. Gjithashtu projektjakti u konsultua edhe nëpërmjet tryezave të diskutimit me shoqërinë civile dhe me anëtarët e grupit të punës, si dhe strukturat e pushtetit vendor për shkrimin e tij pati një kohëzgjatje afërsisht 4 muaj.

3. Metodat e konsultimit

Për konsultimin publik të projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”

u përdorën metodat si më poshtë:

- Konsultimi publik nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike;
- Konsultim në kuadër të Urdhrit të të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Urdhër Nr. 156, datë 28.03.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik të punës për hartimin e ndryshimeve të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ dhe hartimin e planit të procesit të transformimit të qendrave rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë 2025-2026”;
- Takim publik konsultues me aktorë joshpetëror Qershor – Shtator 2025.

Sikurse është përmendur dhe më sipër konsultimi publik i projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për propozimin e projektligjit “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë” ka patur një kohëzgjatje 28 ditë kalendarike nga momenti i shpalljes në regjistrin elektronik të konsultimeve publike. Projektakti u shpall në regjistër për konsultim në datë 03.10.2025 dhe afati i fundit ishte data 30.10.2025.

Nga ana tjetër u zhvilluan 6 takime (fizike dhe online) për diskutimin dhe këshillimin (qershor-shtator 2025) me shoqërinë civile dhe me aktorët e terrenit që operojnë në fushën e shërbimeve sociale, si dhe më shumë se 10 takime konsultative të ngushta teknike me anëtarë të grupit të punës të ngritur me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Urdhër Nr. 156, datë 28.03.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik të punës për hartimin e ndryshimeve të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ dhe planit të procesit të transformimit të qendrave rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë 2025-2026”.

Projektligji është hartuar me ekspertizë teknike ligjore, mbështetur nga UNICEF.

4. Palët e interesuara të përfshira

Në kuadër të konsultimit publik nëpërmjet regjistrin elektronik të konsultimeve publike, kanë ardhur komente, nëpërmjet emailit zyrtar, sugjerime dhe komente nga:

- CRCA
- Bethaby

Në regjistrin e konsultimit publik nuk u regjistrua asnjë koment. Komentet dhe sugjerimet e mëposhtme janë dërguar përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Arsyetimi
Birësimi	Nëse familja biologjike nuk fuqizohet brenda këtij afati (sugjerohet në 3-5 pesë vite), fëmijës duhet t'i jepet mundësia për t'u birësuar. Kjo është thelbësore për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës dhe për të shmangur traumën nga	BETHANY CRCA	Refuzuar	MSHMS ka vlerësuar se birësimi është një institut i rregulluar si nga Kodi i Familjes ashtu edhe me ligj të posacëm ndaj nuk u konsiderua e nevojshme të shtohet një dispozitë specifike për këtë proces.

	ngecja në kujdestari dhe dëmin nga ndryshimi i mbiemrave në moshë madhore. Afati për propozim birësimi: Të specifikohet afati kohor brenda të cilit familja kujdestare mund të hedhë propozimin për birësim.			
Përcaktimi i afatit kohor	Afati kohor i kujdestarisë: Shërbimi i kujdestarisë duhet të jetë një shërbim afatshkurtër, ku fëmija mund të qëndrojë maksimumi 5 vite (siç e kanë shumë vende të botës si Novergjia, Finlanda, Anglia, etj).	BETHANY	Pranuar	Janë parashikuar qëndrimi emergjent, afatshkurtër dhe afatgjatë por nuk mund të vendosen parashikime strikte pasi cdo gje do të orientohet nga planin individual i kujdesit për secilin fëmijë.
Kriteret për ribashkim	Duhet të shkruhen qartë kriteret që duhet të plotësohen nga familja biologjike në rastin e ribashimit me fëmijën.	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Parimet e ribashkimit dhe procesi i riintegrit janë të përcaktuara në ligj (neni 21, 22, 23); kriteret e detajuara teknike përcaktohen me VKM për planin individual të kujdesit.
Afati kohor i takimeve	Duhet të ketë një afat kohor të përcaktuar për periudhën dhe kohëzgjatjen (fashën orare) që familja biologjike mund të takohet me fëmijën	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Ligji vendos kornizën e përgjithshme të ruajtjes së kontakteve (neni 30). Kohëzgjatja, frekuenca dhe oraret e takimeve janë elementë operacionalë dhe përcaktohen me udhëzim/VKM që rregullon marrëdhëniet familje biologjike–familje kujdestare.
Mosha e fëmijës si kriter për kohëzgjatjen e takimeve	Të merret parasysh mosha e fëmijës kur vendoset për kohëzgjatjen e takimeve.	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Parimi i pjesëmarrjes dhe përshtatshmërisë sipas moshës është i detyrueshëm në ligj (neni 5 dhe 16). Detajimi i kohëzgjatjes sipas grupmoshave është standard që përcaktohet në aktet nënligjore
Supervizimi i takimeve nga punonjës social/psikolog	Duhet të përcaktohet në ligj që takimet të supervizohen nga një punonjës social apo psikolog, veçanërisht në rastet kur është e domosdoshme dhe ka rrezik për fëmijën, kur prindërit	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Vendimmarrja profesionale, vlerësimi i rrezikut dhe monitorimi i kontakteve janë të parashikuara (neni 22, 23, 24, 25). Udhëzimi i ministrit do të përcaktojë rastet kur

	kanë varësi alkooli, raste dhune.			takimet duhet të jenë të supervizuara.
Vendimmarrja profesionale, jo gjykata	Vendimi për mënyrën, shpeshtësinë dhe vendin e realizimit të takimeve duhet t'i lihet profesionistit (punonjësit social) i cili e njeh mirë rastin, dhe jo gjykatës.	BETHANY	Pranuar	Vendimet për vendosjen në kujdestari i përkasin gjykatës sipas Kodit të Familjes (neni 19, pika 1). Projektligji minimizon vonesat duke përcaktuar se njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, menjëherë me marrjen e vendimit të arsyetuar nga komisioni shumëdisiplinar për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje, paraqet kërkesën në gjykatë për vendosjen e fëmijës në familjen e përcaktuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes. Nuk mund të shmanget roli i gjykatës për shkak se Kodi i Familjes prevalon mbi ligjet që dalin në bazë dhe për zbatim të tij. Lidhur me këtë çështje është shprehur dhe Ministria e Drejtësisë.
Procedura e udhëtimit	Duhet të përmendet në ligj dhe të qartësohet procedura për daljen jashtë Shqipërisë për vizitë/pushime të familjes me fëmijën në kujdestari (jo për të jetuar jashtë)	BETHANY	Pranuar	Kjo çështje wshtw e rregulluar pikwn 2 tw nenit 29, ku parashikohet se familja kujdestare gëzon të drejtën të shoqërojë fëmijën e vendosur në kujdes alternativ, jashtë vendit, me kushtin që të informojë njësinë/punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në bashki/një dhe autoritetin shtetëror.
Mbrojtja e fëmijës kur ndërveprimi me familjen biologjike krijon rrezik	Të qartësohet si duhet të veprojnë familja kujdestare si dhe profesionisti kur mendon se bashkëveprimi me familjen biologjike i bën dëm fëmijës.	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Procedurat e menaxhimit të rrezikut, ndërprerja e takimeve dhe masat urgjente janë të rregulluara në nenet 23, 24 dhe 25. Standardet nënligjore do të përkufizojnë mekanizmin praktik të ndërprerjes së kontakteve.
Përfaqësim ligjor falas për familjen kujdestare	Familja kujdestare duhet të ketë një përfaqësues ligjor falas (mbështetje ligjore falas) në proceset gjyqësore.	BETHANY	Refuzuar	Ndihma juridike falas rregullohet nga ligji për ndihmën juridike 111/2017; Projektligji nuk mund të përcaktojë kategori të reja përfituese.

Përfaqësim i ndarë për çdo aktor	Duhet të ketë një përfaqësim ligjor specifik dhe të ndarë për secilin aktor (familje kujdestare, familje biologjike, institucioni residencial).	BETHANY	Refuzuar	Përfaqësimi i secilit subjekt në proceset gjyqësore rregullohet nga Kodi i Procedurës Civile. Ndryshimi i këtyre rregullave nuk është kompetencë e projektligjit për kujdesin alternativ.
Transferimi automatik i gjendjes civile pas vendimit të gjykatës	Të sigurohet që transferimi i gjendjes civile të fëmijës të bëhet automatikisht pas vendimit të gjykatës për t'u lehtësuar marrja e dokumentave (si çertifikata) dhe regjistrimi në sistemin arsimor apo qendrat shëndetsore.	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Ligji jep bazën për procedurat administrative pas vendimit. Pika 2 e nenit 20 të projektaktit parashikon se njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për pasqyrimin në aktin e lindjes së fëmijës mbi kujdestarinë në përputhje me Kodin e Familjes dhe për përgatitjen paraprake.
Unifikimi/thjeshtësimi i procedurave në bashki	Procedurat e kujdestarisë, përfshirë marrjen e ndihmës ekonomike dhe dokumentacionin, duhet të jenë të unifikuara në të gjitha bashkitë e Shqipërisë. Të eliminohen kërkesat e zyrave të ndihmës ekonomike për dokumente ekstra (si p.sh. shkarkimi i dokumentit të hyrje-daljeve nga territori) apo nevoja për të firmosur çdo tre muaj që fëmija është ende në kujdestari, të cilat nuk janë standarde dhe shkaktojnë vështirësi.	BETHANY CRCA	Refuzuar	Ligji ofron kornizë procedurale të unifikuar. Gjithashtu shprehemi se familjet kujdestare trajtohen në të njëjtën mënyrë si të gjitha familjet përfituese të ndihmës ekonomike, në përputhje me procedurat e unifikuara të parashikuara në Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”. Aktet normative nënligjore për miratimin e standardeve të shërbimit dhe për procedurat e kujdestarisë do të standardizojnë praktikën në të gjitha bashkitë.
Akses në E-Albania për familjen kujdestare	Familjes kujdestare duhet t'i jepet akses në sistemin E-Albania për dokumentet dhe informacionin e fëmijës në kujdestari (si çertifikatat, vaksinat, notat), në mënyrë që të mos shkojë fizikisht në bashki apo te prindi biologjik.	BETHANY	Refuzuar	Me marrjen e vendimit të gjykatës për vendosjen e fëmijës në familjen kujdestare të drejtën për aksesin në dokumentet e fëmijës është përgjegjësi e kujdestarit ligjor. Aksesin në e-Albania kërkon rregullim teknik/administrativ përmes kuadrit rregullativ të qeverisjes elektronike

Rishikimi i shumës 9,000 lekë	Shuma prej 9.000 Lekë në muaj që jepet për nevojat e fëmijës duhet të rishikohet, pasi nuk është e mjaftueshme.	BETHANY	Refuzuar	Shuma e mbështetjes financiare nuk përcaktohet në ligj, por me akt nënligjor.
Diferencimi i termave “familje kujdestare” dhe “familje kujdestare profesionale”	Të bëhet një diferencë e qartë midis formave të kujdestarisë duke përdorur termat "familje kujdestare" dhe "familje kujdestare profesionale", duke shmangur termin "vullnetare" për shkak të konotacioneve negative dhe keqkuptimit.	BETHANY CRCA	Pranuar	Pika 1 e nenit 8 të projektligjit bën ndarje të qartë mes formave të kujdestarisë;
Numri maksimal i fëmijëve në kujdes alternativ	Të sqarohet dhe përcaktohet në ligj kufizimi i numrit të fëmijëve biologjikë që mund të ketë një familje kujdestare.	BETHANY CRCA	Pranuar	Parashikuar në nenin 18, pika 1 të projektligjit se një familje ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje deri në tre fëmijë njëkohësisht, përfshirë edhe fëmijët biologjikë, të birësuar ose në kujdestari të saj. Përfshirë, më shumë se tre fëmijë vendosen në të njëjtën familje kujdestare në rastet kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijëve dhe nuk cënon cilësinë e kujdesit, në bazë të vlerësimit të kryer nga njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.
Mbështetja financiare e OSHC-ve nga bashkia (kontraktim)	Duhet që bashkia t'i mbështesi financiarisht organizatat e shoqërisë civile përmes kontraktimit për shërbimin e kujdestarisë, jo vetëm me marrëveshje bashkëpunimi vullnetare, në mënyrë që shërbimi të jetë i qëndrueshëm dhe cilësor.	BETHANY	Pranuar pjesërisht	Ligji krijon bazën ligjore për kontraktimin nga bashkitë; mekanizmat financiarë dhe procedurat e kontraktimit përcaktohen me VKM sipas ligjit 121/2016 për shërbimet shoqërore.
Mekanizëm kontrolli për përgjegjësitë e bashkisë	Duke qenë se draft ligji i jep një rol kyç bashkisë (pushtetit vendor), i cili shpesh ka qenë totalisht i	BETHANY CRCA	Pranuar	Roli mbikqyrës/monitorues i bashkive është i përcaktuar në projektakt; monitorimi dhe inspektimi do kryhen nga

	munguar në praktikë, duhet të vendoset një mekanizëm kontrolli që t'i kërkojë llogari bashkisë për kryerjen e detyrave të saj.			strukturat shtetërore sipas Ligjit 121/2016 dhe Ligjit 18/2017, si dhe do specifikohen me akte nënligjore rregullat dhe procedurat për organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit.
Detyrimi për të konsideruar kujdesin alternativ përpara vendosjes në institucion Mosmarrja e mendimit të prindërve biologjikë në rast rreziku	Të sqarohet detyrimi i familjes biologjike që të marrë në konsideratë kujdesin alternativ (familjen kujdestare) përpara se ta lërë fëmijën në institucion. Në rast se një fëmijë ka nevojë për mbrojtje, mos të merret mendimi/vendimi i familjes biologjike për vendosjen në familje kujdestare, ashtu sikurse nuk ndodh kur një fëmijë vendoset në institucion. E cakton profesionisti se cila është alternativa më e mire për fëmijën bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Sidomos në rastet kur prindërit biologjik kanë edhe probleme të shëndetit mendor, apo qe kane probleme me dhunën në familje, përdorues të substancave narkotike, etj.	BETHANY	Pranuar	Parimi i prioritizimit të kujdesit në familje është shtylla themelore e ligjit; profesionisti përcakton alternativën më të përshtatshme për fëmijën, bazuar në interesin e tij më të lartë, pa u kushtëzuar nga pëlqimi i prindërve biologjikë në rastet kur ekziston rrezik apo abuzim
Mbështetje profesionale (terapi, këshillim, lehtësime në arsim, bonus qiraje, programe sociale)	Familjet kujdestare duhet të jenë të mbrojtura nga ligji dhe të kenë mbështetje profesionale në shumë drejtime nga shërbimi social si terapi për fëmijën i cili vjen me trauma, këshillim familjar, trajnime, faciliteti për regjistrimin e fëmijës në sistemin arsimor, përfitime nga programet sociale të bashkisë si bonus qeraje	BETHANY	Pranuar	Ligji njih të drejtën për mbështetje profesionale; shërbimet specifike, përfshirë terapinë dhe këshillimin (neni 28 i projektligjit). Sa i takon orientimit arsimor dhe aksesit në programet sociale, fëmija dhe familja kujdestare asistohen nga strukturat vendore dhe përfitojnë sipas përcaktimeve të legjisllacionit përkatës në fuq
Përfundimi i të drejtave prindërore pas një periudhe (p.sh. 18 muaj)	Duhet të adresohet përfundimi i të drejtave prindërore të familjes biologjike pas një kohe të caktuar (p.sh. 18 muaj).	BETHANY	Refuzuar	Nuk mund të parashikohet në këtë ligj. Heqja ose kufizimi i të drejtave prindërore rregullohet nga Kodi i Familjes dhe kërkon vendim gjyqësor individual.

Kriteret e ribashkimit familjar	Duhet të shkruhen qartë kriteret që duhet të plotësohen nga familja biologjike në rastin e ribashimit me fëmijën.	BETHANY	Pranuar	Parashikimi i ribashkimit buron nga e drejta e familjes biologjike për të ruajtur kontaktin, për t'u informuar dhe për t'u përfshirë në programet e prindërimit dhe riintegrit, duke garantuar që çdo vendimmarrje të bazohet në interesin më të lartë të fëmijës dhe të zbatohet në kuadër të planit individual të kujdesit alternate- neni 30 I projektligjit
Planifikimi dhe rishikimi i kujdesit	Organizatrat kanë rekomanduar të përcaktohen afate të qarta rishikimi (fillestar, 3-mujor, 6-mujor) sipas praktikave të vendeve me sisteme të avancuara.	CRCA	Pranuar	Këto aspekte do të rregullohen në VKM, ndërsa afatet maksimale janë përfshirë në draft ligj
Deinstitucionalizimi	Sugjerohet të lidhet kujdesi familjar me strategjinë dhe objektivat e DEI	CRCA	Pranuar	I gjithë projektligji kontribuon drejtpërdrejt në procesin e deinstitucionalizimit, duke forcuar kalimin nga kujdesi rezidencial drejt kujdesit komunitar me bazë familjen. Gjatë hartimit të tij është punuar paralelisht edhe me Planin e Transformimit të Institucioneve Rezidenciale, me synimin për të siguruar një ndërthurje të qartë dhe të qëndrueshme ndërmjet kuadrit ligjor dhe reformës së transformimit të shërbimeve.
Regjistri elektronik	Sugjerohet të përfshihen tregues për rezultatet dhe publikime periodike me të dhëna të anonimizuara	CRCA	Pranuar	Anonimimi është pjesë e mborjtjes së të dhënave personale. Projektligji e ka përfshirë ndër parimet themelore – neni 14